

INICIATIVA KOSOVARE PËR STABILITET
KOSOVAR STABILITY INITIATIVE

**INICIATIVA KOSOVARE PËR STABILITET
KOSOVAR STABILITY INITIATIVE
IKS**

**Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorëve të pavarur
31 Dhjetor 2017**

Përmbajtja:

Raport i auditorëve të Pavarur.....	3
Bilanci i Gjendjes.....	5
Pasqyra e te Ardhurave dhe Shpenzimeve.....	6
Pasqyra e Rrjedhës së Parasë.....	7
Pasqyra e Ndryshimeve në Fonde.....	8
Shënimet e pasqyrave financiare.....	9-15

Raport i Auditorëve te pavarur

Drejtuar: Menaxhmentit te Inicativës Kosovare Për Stabilitet

Raport mbi Pasqyrat Financiare

Opinion i pa kualifikuar

Ne kemi audituar pasqyrat financiare te bashkëngjitura të Iniciativa Kosovare për Stabilitet (në vijim referuar si “Organizata” apo “IKS”) të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar të datës 31 dhjetor 2017, pasqyrën e të hyrave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e rrjedhës së parasë dhe pasqyrën individuale të ndryshimeve në fonde për vitin e mbyllur në këtë datë dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël si dhe informacionin tjetër shpjegues te përfshira ne fq. 5-15.

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Organizatës më 31 dhjetor 2017, dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e përfunduar në pajtim me Parimet e Përgjithshme te Pranueshme te Kontabilitetit.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në Përgjegjësitë e Auditorit ne paragrafin për Auditimin e Pasqyrave Financiare të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistet Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistet Kontabël (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe ne kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodit IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.

Çështjet kryesore të auditimit

Çështjet kryesore të auditimit janë ato çështje që, sipas gjykimit tonë profesional, ishin të një rëndësie më të madhe në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Këto çështje janë trajtuar në kontekstin e auditimit të pasqyrave financiare në tërësi, dhe në formimin e opinionit tone më sipër, dhe ne nuk do të japin një opinion të veçantë mbi këto çështje.

Ne kemi vendosur se nuk ka çështje të rëndësishme të auditimit për të komunikuar në raportin tonë.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe e atyre te ngarkuar me qeverisje për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare te Raportimit Financiar dhe për ato kontrole të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së kompanisë për të vazhduar aktivitetin e saj (parimi i vijimësisë), shpalosjen, sipas rastit, te çështjeve që lidhen me parimin e vijimësisë dhe përdorimin bazës së kontabilitet sipas parimit të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon të likuideojë Kompaninë ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste përveç për ta bërë këtë.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, dhe për të nxjerrë raportin e një auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.


Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionit mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Shpalosja,



Elmije Osmani
Auditor Ligjor
Tel: +377 44 138 551



15 Shkurt, 2018

Pasqyra e Pozitës financiare

	Shënimi	Dhjetor 31, 2017 (në EUR)	Dhjetor 31, 2016 (në EUR)
ASETET			
Asetet jo-qarkulluese			
Prona, impiantet dhe pajisjet	3	-	-
Totali i aseteve jo-qarkulluese		-	-
Asetet qarkulluese			
Llogaritë e arkëtueshme			0.00
Të arkëtueshmet tjera			1,476.98
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	4	34,160.60	38,581.37
Totali i aseteve qarkulluese		34,160.60	40,058.35
TOTALI I ASETEVE		34,160.60	40,058.35
DETYRIMET DHE EKUITETI			
Detyrimet rrjedhëse			
Ll. e pagueshme dhe shpenzimet akruale	5	2,716.87	5,690.13
Të hyrat e shtyra	6	30,069.78	32,863.18
Totali i detyrimeve rrjedhëse		32,786.65	38,553.31
Ekuiteti			
Fondet e bartura		1505.04	1505.04
Deficiti/suficiti neto për vitin		(131.09)	-
Totali i ekutetit		1,373.95	1505.04
TOTALI I DETYRIMEVE DHE EKUITETIT		34,160.60	40,058.35


Këto pasqyra financiar janë aprovuar nga Menaxhmenti i Organizatës me 18 Janar 2018 dhe autorizuar për publikim nga:

Executive Director

 Znj. Florina Duli



Financial Manager


 Znj. Florina Baruti

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse

	Notes	Viti që përfundon me 31 Dhjetor	
		2017 (në EUR)	2016 (në EUR)
Të hyrat			
Te hyrat nga grantet	7	196,832.47	264,685.40
Te hyra te tjera		345.89	120
Total të hyrat		197,178.36	264,805.40
Shpenzimet			
Pagat dhe benefitit e stafit	8	127,930.75	113,268.57
Qiraja		8,956.03	6,593.40
Pajisje dhe materiale për projekt		11,198.89	7,542.81
Shpenzimet e rrymës dhe ujit		1,183.61	1,787.37
Telefoni dhe interneti	9	2,648.11	1,923.73
Furnizime për zyre		2,454.68	1,119.77
Udhëtime dhe vizita studimore	10	5,367.48	27,640.82
IT & mirëmbajtja e uebfaqës		587.56	190.4
Shpenzime për auditim		2,100.00	2,100.00
Printime dhe aktivitete visibiliteti	11	22,882.81	25,430.42
Shërbime te kontraktuara	12	5,620.00	26,511.42
Shpenzimet e bankës		981.04	1,221.82
Zhvlerësimi			
Te tjera		5,398.49	49,474.87
Totali i shpenzimeve		197,309.45	264,805.40
(Deficiti)/Suficiti për këtë vit		(131.09)	-

Pasqyra e rrjedhës së parasë

	Fundi i vitit 31 Dhjetor	
	2017	2016
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operuese (Deficiti)/suficiti gjatë periudhës Zhvlerësimin	(në EUR) (131.09)	(në EUR) -
Ndryshimet në të arkëtueshme	1,476.98	3,020.00
Ndryshimet në të arkëtueshme tjera		6,817.03
Ndryshimet në të pagueshme	(2,973.26)	3,015.06
Ndryshimet në detyrime tjera	(2,793.40)	(83,897.76)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative	(4,420.77)	(71,045.67)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese Blerja e pronës dhe e pajisjeve		
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese		
Ndryshimet neto në para dhe ekuivalent	(4,420.77)	(71,045.67)
Paraja dhe ekuivalentet e parasë më 01 Janar	38,581.37	109,627.04
Paraja dhe ekuivalentet më 31 Dhjetor	34,160.60	38,581.37

Pasqyra e ndryshimeve ne fonde

	Fondet
	(në EUR)
Gjendja fillestare më 01 Janar ,2016	1,505.04
Suficiti i vitit 2016	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2016	1,505.04
Deficiti i vitit 2017	(131.09)
Gjendja më 31 Dhjetor 2017	1,373.95

1. Informata te përgjithshme

Iniciativa Kosovare për Stabilitet - IKS është institut kërkimor dhe zhvillimor i pavarur, jo profitabil që fokusohet në hulumtime empirike dhe analiza të zhvillimeve shoqëro-ekonomike në Kosovë. E themeluar në vitin 2004, IKS ofron hulumtime inovative dhe të ndërlydhura me politika relevante, me qëllim të inicimit të debateve mbi çështje të rëndësishme për zhvillimin e ardhshëm të Kosovës.

Misioni i Iniciativës Kosovare për Stabilitet (IKS) është të kontribojë në avancimin e mirëqenies së qytetarëve të Kosovës përmes hulumtimeve empirike, nxitjen e politikbërjes së mirëinformuar, ngritjes së vetëdijes qytetare, bashkëpunimit rajonal, avokimit dhe rrjetizimit.

Ne besojmë që debatet rreth politikave publike të bazuara në fakte përbëjnë themelin e një vendim-marrje demokratike

Që nga themelimi, puna e IKS-it është angazhuar për çështje si qeverisja e mirë, zhvillimi ekonomik, planifikimi urban, papunësia dhe të rinjtë, reforma e administratës publike, dialogu social, anti-korrupsioni dhe korrupsioni në procesin e rindërtimit të pas luftës, mbrojtja e ambientit, arsimit, imazh i Kosovës dhe trashëgimia kulturore.

Të gjitha raportet janë në dispozicion në adresën tonë elektronike www.iksweb.org

2. Bazat e përgatitjes dhe politikat e rëndësishme të kontabilitetit

2.1 Politikat e rëndësishme të kontabilitetit

a) Deklarata e përputhshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në pajtueshmëri me Parimet e Përgjithshme të Pranueshme të Kontabilitetit.

b) Bazat e përgatitjes dhe prezantimit

Pasqyrat financiare janë të prezantuara në Euro. Këto pasqyra financiare janë përgatitur në pajtueshmëri me konventën e kostos historike. Politikat e kontabilitetit janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme, dhe përveç nëse ceket ndryshe, ato janë të njëjtat me politikat aplikuar në vitin paraprak.

Periudha raportuese e organizatës është 12 muaj duke mbaruar me 31 Dhjetor të secilit vit. Pasqyrat Financiare janë përgatitur në baza krahasuese duke reflektuar bilancet e këtij viti dhe të atij paraprak.

c) Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë bilancet e parasë së gatshme dhe ato të depozituara në bankat vendore.

d) Prona, impiantet dhe pajimet

Zërat e përfshirë në këtë kategori përfaqësojnë vetura, pajisjet e zyrës dhe pajisjet e teknologjisë informative dhe njihen si asete vetëm kur është e mundur që:

- benefitet e ardhshme ekonomike të lidhura me asetin do të rrjedhin në Organizatë dhe
- kosto e asetit mund të matet me besueshmëri.

Asetet fillimisht regjistrohen sipas koston. Kostoja përfshin të gjitha shpenzimet direkt të atribueshme në përvetësimin e zëri.

Organizata e mban asetet në kosto historike minus zhvlerësimi i akumuluar apo humbjet e akumuluar të demit, nëse ka. Zhvlerësimi i aseteve regjistrohet në baza vjetore duke përdorur metodën lineare dhe duke pas parasysh jetëgjatësinë e aseteve. Normat e aplikuar të zhvlerësimit janë:

- Veturat - 20 %
- Pajisjet tjera – 20 %

e) Grantet

Grantet janë njohur vetëm kur ka siguri të arsyeshme se:

- Organizata do të përmbushë të gjitha kushtet e bashkangjitura atyre; dhe
- grantet do të pranohen.

Grantet operative janë njohur si e hyrë përgjatë periudhës së nevojshme për ti lidhur ato me kostot, për të cilat janë menduar të kompensohen, në bazë sistematike. Grantet e shënuara për përvetësimin e pasurive janë shtyrë dhe njohur si e hyrë përgjatë kohës së përdorimit të pasurisë përkatëse.

f) Llogarite e pagueshme

Llogaritë e pagueshme janë njohur kur shuma është e përcaktueshme dhe obligimi për të shlyer shumën ekziston si rezultat i operacioneve të Organizatës. Ato janë paraqitur në kosto.

a) Shpenzimet

Shpenzimet njihen në momentin kur ndodhin.

b) Valutat e huaja

Transaksionet në valuta të huaja janë regjistruar në pajtueshmëri me normën valide të këmbimit në datën e transaksionit. Ndryshimet janë regjistruar në pasqyrën e të ardhurave si fitime/humbje.

Në funde të vitit, bilancet e mbetura në valuta të huaja janë konvertuar duke përdorur kursin e këmbimit në ditën e fundit të periudhës raportuese. Fitimet apo humbjet nga këto këmbime janë njohur në pasqyrën e të ardhurave.

c) Tatimi në fitim

Organizata është e liruar nga tatimi në fitim.

d) Te hyrat & shpenzimet

Gjate kësaj periudhe, Organizata ka pranuar gante për të financuar aktivitetet dhe operacionet e projekteve. Grantet janë pranuar për projekte specifike të dorëzuara tek donatorët dhe të aprovuara prej tyre.

3. Prona dhe pajisjet

Në bazë të ligjeve Kosovare në fuqi, të gjitha pajisjet e blera me vlerë më të vogël se 1,000 EUR janë të prezantuara dhe përfshira në pasqyrën e të ardhurave. Tabela më poshtë paraqet blerjet mbi vlerën 1,000 EUR:

	Veturat	Totali
<i>Kosto</i>		
Më 01 Janar 2017	11,481	11,481
Shtesat	-	-
Transferet	-	-
Shitjet	-	-
Më 31 Dhjetor 2017	11,481	11,481
<i>Zhvierësimi i akumuluar</i>		
Më 01 Janar 2017	11,481	11,481
Zhvierësimi i ngarkuar gjatë vitit	0	0
Shitjet		
Më 31 Dhjetor 2017	11,481	11,481
<i>Vlera e bartur</i>		
Më 01 Janar 2017	0	0
Më 31 Dhjetor 2017	0	0

4. Paraja dhe ekuivalentet e parasë

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
	(në EUR)	(në EUR)
Paraja e gatshme	49.38	76.2
Paraja në banka	34,111.22	38,505.17
Totali parasë dhe gjendjes në bankë	34,160.60	38,581.37

5. Llogaritë e pagueshme dhe shpenzimet akruale

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
	(në EUR)	(në EUR)
Llogaritë e pagueshme	2,716.87	5,690.13
Shpenzimet akruale		
Totali i llogarive të pagueshme dhe shpenzimeve akruale	2,716.87	5,690.13

6. Të hyrat e shtyera

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
	(në EUR)	(në EUR)
Të hyrat e shtyera	30,069.78	32,863.18
Totali i të hyrave të shtyera	30,069.78	32,863.18

Lista e të hyrave të shtyera:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
	(në EUR)	(në EUR)
Komisioni European		-
Anticorrp		3,507.42
Sida	19,611.51	18,897.49
Të tjerë	10,458.27	10,458.27
Total	30,069.78	32,863.18

Bilanci i mbetur nga Sida

	31 Dhjetor 2017
	In EUR
Bilanci në fillim të vitit	18,897.49
Fondet e pranuar	168,293.57
Shpenzimet e Paguara	167,579.55
Bilanci i mbetur për vitin vijues	19,611.51

7. Të hyrat nga grantet

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
	(në EUR)	(në EUR)
Të hyrat nga grantet		
Anticorp	3,507.42	13,415.65
Sida	167,579.55	107,223.25
Ambasada Britaneze		8,730.63
Komisioni Evropian		107,578.24
GIZ	8,785.50	12,335.50
Tjera	16,960.00	15,402.13
Totali i të hyrave	196,832.47	264,685.40

8. Pagat dhe benefitet e personelit

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
	(në EUR)	(në EUR)
Pagat e personelit kryesor	121,838.82	108,227.45
Kontributi pensional	6,091.93	5,041.12
Totali i pagave dhe benefiteve	127,930.75	113,268.57

9. Telefoni dhe interneti

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
	(në EUR)	(në EUR)
Telefoni	2,168.67	1,374.49
Interneti	479.44	549.24
Totali për telefon dhe internet	2,648.11	1,923.73

10. Udhëtimi

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
	(në EUR)	(në EUR)
Vizitat studimore		15,423.74
Akomodimi		5,824
Shpenzime udhëtimi	2,653.32	5,736.54
Shpenzime të veturave	2,714.16	656.09
Totali i shpenzimeve të udhëtimit	5,367.48	27,640.82

11. Përkthimi dhe printimi

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
	(në EUR)	(në EUR)
Debate	22,200.00	7,000
Printimi dhe aktivitete visibilitetit	682.81	18,430.42
Totali i përkthimit dhe printimit	22,882.81	25,430.42

12. Shërbimet e Kontraktuara

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
	(në EUR)	(në EUR)
Shërbimet e kontraktuara	5,620.00	26,511.42
Totali i shërbimeve të kontraktuara	5,620.00	26,511.42